

• **20 VENDE TË LIRA PËR PUNONJËS OFICER TË NIVELIT TË MESËM (GRADA NËNTOGER DERI KAPITEN)**

I. **KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJNË KANDIDATËT PËR OFICER:**

- ✓ Të jenë diplomuar në Akademinë e Policisë, në Akademinë e Mbrojtjes (diplomuar në specialitetin: gjitharmësh, zbulim dhe forcat speciale) ose në shkolla të tjera ushtarake jashtë vendit, të njohura në sistemin e arsimit ushtarak në vendin tonë.
- ✓ Të nënshkruajnë kontratën e pranimimit me afat 5 vjeçar.

II. **DOKUMENTAT QË DUHET TË PARAQESIN KANDIDATËT**

Aplikantët duhet të paraqesin në fazën e parë të konkurrimit dokumentat e mëposhtëm:

1. Kërkesë
2. CV (Kurikulum vitae)
3. Kopje të kartës së identitetit
4. Dëftesën e shkollës së mesme ose listë notash, **të cikluar** në Drejtorinë Arsimore të Rrethit, **të fotokopjuar dhe të noterizuar**.
5. Diplomën e shkollës së lartë së bashku me listen e notave
6. Vërtetim nga Gjykata
7. Vërtetim nga Prokuroria
8. Raport i aftësisë në punë (sipas shtojcës V, të VKM nr.596, datë 4.9.2019), nga mjeku i familjes.
9. Dëshmi për kualifikimet e kryera (nëqoftëse ka)
10. Deklaratë personale mbi pastërtinë e figurës (Plotësohet kur aplikanti paraqitet për testim)
11. Dy foto të printuara (9 X 12) me kostum dhe kollare (fotot të dorëzohen edhe me CD).

Dokumentat do të dërgohen me postë në adresën: Garda e Republikës, Rruga e Elbasanit, Pallati i Brigadave, Tiranë, brenda datës 15.06.2020.

III. **TESTIMI I KANDIDATËVE**

Kandidatët duhet të paraqiten **në orën 9⁰⁰ të datës 22.06.2020**, në adresën: Qendra e Formimit dhe Kualifikimit Profesional të Gardës së Republikës, Mullet, Tiranë, **të veshur me uniformë sportive dhe atlete.**

Kandidatët do t'i nënshtrohen testimit në tre faza:

- Intervista
- Vlerësim i aftësive shëndetësore
- Testim i aftësive fizike

Vlerësimi i aftësive fizike do të bëhet në bazë të komponentëve të mëposhtëm:

Nr	ELEMENTËT TESTUES	PËR SASINË/ KOHËN	PIKËT	VLERËSIMI
----	-------------------	-------------------	-------	-----------

		Meshkuj	Femra		
		55 -60 50- 55 47 -50 nën 47	25 -30 20 -25 17- 20 nën 17		
1	Ulje – ngritje me forcën e krahëve (pompa) për kohën 2’.				Shumë mirë Mirë Kalueshëm Dobët
2	Palosje – shpalosje me muskujt e barkut për kohën 2’.	55 -60 50- 55 47 -50 nën 47	25 -30 20 -25 17- 20 nën 17	100 90 80 70	Shumë mirë Mirë Kalueshëm Dobët
3	Tërheqje në hekur	14- 16 12- 14 10- 12 nën 12	6-8 4- 6 2- 4 nën 4	100 90 80 70	Shumë mirë Mirë Kalueshëm Dobët
4	Vrapim rezistence 3000m me uniformë sportive.	13’ 13’ 15’’ 13’ 30’’ 13’ 50’’ 14’ 14’ 30’’ mbi 14’ 30’’	16’ 17’ 17’30 18’ 18’ 30’’ 19’ mbi 19’	100 90 80 70 60 50 40	

IV. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Vlerësimi i përgjithshëm:

Me 400 pikë Shumë mirë
Me 360 pikë Mirë
Me 320 pikë Mjaftueshëm
Nën 320 pikë Dobët

Kandidatët aplikues që të kualifikohen në fazën e parë dhe të pranohen për të vazhduar konkurrimin në fazën e dytë, duhet që në testimin fizik bazë të arrijnë rezultatin minimal 320 pikë dhe Vlerësimin Mjaftueshëm (ose rezultatin minimal me 80 pikë për çdo element të testimit).

V. KOMUNIKIMI I REZULTATEVE TË KONKURIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, të gjithë kandidatët fitues në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike (e-mail personal) ose me telefon nga Garda e Republikës.